

ZGJEDHJET E 23 QERSHORIT PER PREFEKTUREN E KORCES, KU BEN PJESE EDHE MOKRA

# Nis fushata, dy koalicionet e mëdha paraqesin kandidatët



Në vitin 2009 në qarku i Korçës, Partia Demokratike dhe Partia Socialiste morën një numër të barabartë mandatesh, nga deputetë secila. Por ky rezultat nuk la të kënaqur Partinë Socialiste që synonte të merrte shtatë mandate.

Edhe pse bashkia e qytetit të Korçës dhe shumica e komunave i takojnë opozitës, PS nuk e ka nisur mbarë fushatën në këtë qark. Fillimisht Edi Rama hoqi nga ky qark Ben Blushin, cili do të drejtojë fushatën e Elbasanit, dhe në këtë mënyrë Edi Rama delegoi në Korçë, Erjon Braçen. Por deputeti socialist u rebelua ndaj këtij vendimi, duke mos dashur të shkëputej nga Berati. Pikërisht nga këtu nisi dhe ftohja mes Ramës dhe Braçes, mar-

rëdhënie e cila e tani është konsoliduar sërish. Në krye të listës së kandidatëve për deputetë të këtij qarku do të jenë Bashkim Fino e Arta Dade. Dhe pikërisht këta dy figura do të jenë simbolet e fushatës së PS në këtë qark.

Partia Demokratike do të ketë sërish në krye të listës figura të "kalibrit të rëndë" si ministri i Financave, Ridvan Bode. Ky i fundit do të mbajë pothuajse i vetëm komplet fushatën e Korçës. Por edhe PD, ashtu si PS, synon që në këtë qark të marrë shtatë mandate. Ndërkohë që Lëvizja Socialiste për Integritet në këtë qark do të ketë Piro Kapuranin dhe Mimoza Gushon, megjithëse dihet se kjo parti në këtë qark ka arritur rezultate zhgënjyese.

## PARTIA DEMOKRATIKE

1. Ridvan Bode
2. Eleina Qirici
3. Edmond Spaho
4. Fatmir Mediu
5. Gjergji Papa
6. Fatbardh Kadilli
7. Leonard Olli
8. Viktor Duro
9. Ledina Aliolli
10. Sorina Koti

11. Adriana Hysenbegasi
12. Artan Zaimi

7. ARDIT KONOMI
8. ARTUR PORPOLLOGU
9. ANA VERUSHI
10. ADRIATIK BRAÇE
11. ZAMIRA BEQIRAJ
12. ILIR TORRA

## PARTIA SOCIALISTE

1. BASHKIM FINO
2. ARTA DADE
3. OLTA XHAÇKA
4. ILIRIAN PENDAVINJI
5. ILIR XHAKOLLI
6. YLLI ZIÇISHTI

- LSI  
 PIRO KAPURANI  
 MIMOZA GUSHO

ME RASTIN E 14 VJETORIT TË GAZETËS  
**Gazeta "Mokra,, ka vendin e vet, në informacionin që u jep lexuesve**



Redaksia e gazetës "Mokra" uron kryetarin e shoqatës, z. Pellumb Zade, për lindjen e dy djemve binjakë, jetë të gjatë e të lumtur!

Me rastin e 70-vjetorit të krijimit të Çetës partizane të Mokrës (mars 1943- 2013)



## Jehona e çetave partizane në luftimet kundër armikut në Snosmi e Bulçar

Nga Llazi TONA

## Mirënjohja në Mokër është tipar i kultivuar

Nga Zenun FERRO

## Ajaz Bego, me vitet e respektin mbi supe

## Sfilitjet shpirtërore të Kutelit në

## penën e Tomi Matos

Nga Kostaq XOXA





# Mirënjohja në Mokër është tipar i kultivuar



Nga Zenun FERO

Mirënjohja është një nga cilësitë e mokrarëve, kjo është rrënjësor dhe trashëguar brez pas brezi, edhe në ditët tona. Nëse ndonjë nuk tregon mirënjohje, nuk kemi pse të shqetsohemi. Është e natyrshe që njerëzit harrojnë të tregohen mirënjohës, pra nëse presin mirënjohje, është e sigurtë që na presin shumë kokëçarje.

Një nënë në Mokër, kishte rritur mbesa e nipër, por ato nuk i vinin më, sepse ajo u kërkonte me fjalë mirënjohje të thellë. Ata nuk e duronin dot këtë zonjë të nderuar. Asnjëherë nuk do ta marrësh mirënjohje ose dashuri pa shpresuar që të ta kthejnë. Aristoteli thoshte: "Njeriu ideal ka kënaqësi duke u bërë nder të tjerëve". Një fëmijë mos mirënjohës ther më shumë se dhëmbi i gjarpërit" thërriste mbreti Ilir i Shekspir-it,, Po pse duhet të jenë mirënjohës fëmijët, nëse neve nuk i edukojmë që të jenë të tillë? Mos mirënjohja është e natyrshe, si barishtet. Mirënjohja është si trëndafil. Për trëndafilin duhet treguar kujdes. Ajo kultivuar. Trëndafilin duhet ta duash dhe ta mbrosh. (Dale Carnegie "Si të mposhtësh shqetësimet dhe të fillosh të jetosh" Tiranë, 2010)

Për fëmijët mos mirënjohës kush e ka fajin? Ndoshta, ne prindërit, sepse nuk i kemi mësuar si duhet që ata të shprehin mirënjohjen ndaj të tjerëve, prindërve, dhe kujdo që ai bisedon e komunikon?. Fëmijët tanë janë ashtu siç i bëjmë ne. Një nënë në fshatin Slabinj, fisi balliu, kishte gjashtë fëmijë dhe i rriti me shumë vështësi. Në këtë kohë janë të gjithë në punë, në emigracion dhe të gjithë kërkojnë ti marrin prindërit secili në shtëpitë e tyre. Këta nuk ngopen me ata. Kjo është mirënjohja e fëmijëve për prindërit që i rritën dhe sot ata ja kthejnë mirënjohjen atyre. Ata fëmijë që në vogëli kanë thithur ngrohtësinë e familjes, të prindërve, kanë njohur të kaluarën e vuajtjet e tyre dhe sot respektojnë vlerësojnë mirënjohjen më të madhe për ta. Nuk duhet harruar se të rritësh fëmijë të edukuar dhe mirënjohës duhet që edhe vetë të jesh patjetër mirënjohës dhe i respektuar. Fëmija do ta më-

## Letër në burg shokut tonë të mirë, Zenun!

Nga Koço Piqoni

I dashur shoku jonë i mirë Zenun, dëshiroj të jeni shëndoshë e mirë . me anën e kësaj letre publike dëshiroj të shpreh dëshpërimin tim e të shumë shokëve e miqve të tuaj antarë të degës së shoqatës Pelioni e lexues të gazetës Mokra ku ju pa mëdyshe jeni njeriu më i përkushtuar dhe qëndror , për ne e banorët e krahinës së Mokrës sonë të dashur për të cilën juve keni bërë dhe do bëni shumë për atë mokër lashtë të vuajtur , bujare , heroike por gjithmonë patriotike , bir i denjë i së cilës jeni dhe ju . i dashur Zenun mos u dëshpëro e mos u thyej moralisht , bëju trim se edhe i tillë je, kam bindje se do ta kalosh me burrëri , se nuk je as i pari as i fundit që ku shkuar "ushtar" bedel për djajtë . duhet të dini i dashur Zenun se i drejti ka vuajtur e do vuajë gjithmonë në shoqëri të pa drejta ku për moral nuk është ligji e drejtësia po intriga hipokrizia e babëzia për para, qoftë dhe të përlyera me gjakun e njerëzve të cilët përpiqen të jetojnë me djersën e ballit e të tjerë faqe zinj që kandidojnë për të përfaqësuar " ty o popull " prandaj dhe këndohet : O ti moj Varfëri e mjerë , njerëzit më të mirë ti i ke , paratë e pista

nuk kanë vlerë, po nuk pate nder në shoqëri .

Vite më pasë nga viti 1968 kam lexuar " Sekretin Ushtarak "pre të cilit edhe sot kam të ngulitur në mendje porosinë e një personaliteti i cili i linte si porosi " Testament " disa thënje djalit të tij : Biri im, njeriu mundet të meret në qafë nga këto vese a qëndrime.1- Duke ndenjue pas të mëdhenjve 2- Duke qënë llafazan . 3 - Duke bërë atë që nuk duhet të bëjë, e duke mos bërë atë që duhet të bëjë.

4 - Firma është helm .

5 - Një diçka quhet sekret, kur ai dihet nga një person n,q . s dihet nga dy persona a i ka 50% të vlerës dhe n . q . s Një sekret dihet nga një femar ai nuk është më i tillë .

Për ilustrim po ju shkruaj dy rëfime për të ilustruar se i drejti vuan , shkon bedel dhe se shpejta von e drejta vuan, për aq kohë së e keqja është në pushtet .

Vite më parë në qytetin e Pogradecit ish drejtor në Nd Tregëtisë një intelektual i nderuar i shkolluar në B .Sovjetik për financa i ndjeri Th. Borova i cili shkëlqeu në administrimin e ndërmarjes dhe furnizimin e tregut me prodhime e produkte ushqimorë,por që nga një kontroll i ushtuar në atë ndërmarje u gjendën disa shkeje të cilat personat të gjendur me shkelje çfajësosheshin se kishin urdhëra me shkrim të firmosura nga drejtori

të cilat e kompromentonin atë , si shkelës të ligjit, për të cilat edhe ai u dënua disa vjet me burg . pasi e kreu dënimin këthehet në qytet dhe një ditë takon një shok e mikun e tij, atëhere drejtor në Nd Gjolllogjisë të ndjerin sot Th . Niça i cili pasi e takoj e uroj për mirëseardhjen shpyqyr që ardhe shëndoshë dhe shpyqyrqë i gjete mirë njerëzit e shtëpisë e më pas e ftoj përnjë kafe, në atë bisedë i posa dali nga burgu i thotë shokut të tij, se nuk e kisha menduar kurë të më ndodhte një gjë e tillë se kam punuar me ndershmëri e drejtësi .

Atëhere miku i tij i madhi Th . Nica i thotë se të dinja të zgjuar po ja ta mësosh nga unë në tregëti duhet shumë kujdes të mos e humbësh mendjen, asnjë herë të mos të të dalë frika, duhet me një dorë ta kapish atë mikun e tja kallësh tjetrit, dorën tjetër ta mbash prapa të ruesh mos ta kalin ty, duket ty të doli frika dhe tashi , kot që ankoresh .

\* Tregohet se dikur një bukë pjekës Furxhi në në të gëdhirë të një nate dimëri ku gjatë asaj nate kish rënë mbi një pëllëmbë dëborë në afërsi të furës së tij , ai dëgjon një rënkim njeriu i cili ishte i mbuluar me dëborë dhe i shkon në ndihmë, shilon se atij të mjeri i kishin ngulur një thikë mbas shpine dhe ky Furxhi nuk nguroj

, ja hoqi thikën e ngulur në atë kohë filluan të lëvizin e të tjerë në atë rrugë dhe shkuan në ndihmë në atë kohë kur furxhiu i kish hequr thikën dhe ai mjeran pas atij veprimi tha Më vrave o të vraftë zoti dhe dha shpirt . i shte kjo skenë dhe deponimi i aty dëshmitarëve fjalët që kishin dëgjuar nga viktima të cilat shërbyen si prova që fajësuan furxhinë dhe gjykata dha vënimin më vdekje pushkatim . Vite më von vrasësi i vërtetë dëshmon për atë vrasje dhe shkaqet për të cilën e kish kryer atë vrasje . Atëhere ajo gjykatë Franceze e shpalli Furxhinë të pa fajshëm , e dëm shpërbleu familjen e tija dhe foton e atij Furxhiu e vendosën në të gjitha gjykatat e vëndit nuke e shoqëruar me këtë nënshkrim , Askush nuk duhet të dënohet pa u vërtetuar fajësia e tij . I dashur shoku jonë Zenun në përfundim të këtyre reshtave pranoni të falë me shëndet nga Istrefi , Tomi , Llazi , Bujari , Përparimi , Dhimitëri , Nesti ,Xhevairi , Ylli , Malliqi , Hasani , etj , etj sigurisht dhe nga unë shkruesi Koco Pihoni , kam mësuar nga bisedat që kam pasur me Zabitin se ai ka kontaktuar me ju dhe e kam falënzdëruar se e di sa e nevojshme është kontakti me sa më shumë shokë e miq në këto ditë të pa dëshiruara . mendoj se shok e mik më të mirë duhet të kesh librin e lapsin me majë të mprehtë.

Ju përqafoj edhe një herë.

sojë instinktivisht e jo me ndërgegje mënyrën e komunikimit, të mirënjohjes, të respektit, traditës, zakonit, lavdërimit, dhe të vlerësimit prindëror. Pasiviteti në mokër nuk qëndron, ai luftohet çdo ditë e në çdo çast të jetës dhe aktivitetit njerëzor. Ai është mungesë ndjenje, dëshire, apati e përgjithshme, indiferencë dhe portali. Një mendje e zbrastë dhe pasive mund të mbushet lehtësisht me të gjitha llojet e mendimeve të gabuara. Veprimi i drejtë nis me mendimin e drejtë, mos dhe jo pasivë në mendjen tuaj. Mendoni me dashuri, se vetëm kështu edhe njerëzit do të shohin me dashuri e mirënjohje do të sillen me dashuri e respekt pavarësisht se si janë por një kohë do ta kuptojnë dhe do të respektojnë e japin maksimumin e mirënjohjes. Mendimet dhe fjalët janë magazine ose aramë, të cilat mbajnë fuqi krijuese ose shkatërruese.

Falënderimi për Mokrën është parim jete. Një njeri që nuk ka një mendje falënderuese, atëherë nga goja e tij s' do të dalë asnjë falënderim. Kur duhet të afrojmë falënderime? Gjatë gjithë kohës kudo që kemi mundësi, në çdo situatë pune dhe komunikimi. Vetëm kështu neve futemi thellë në jetën fitimtare ndaj tjetrit. Kur dikush bën diçka të mirë, për ju bëjani të ditur se jeni mirë njohës. Nëse nuk i japin diçkaje vlerësimin e duhur, atëherë me siguri do ta humbisni atë. Marrëdhëniet e mira ndërtohen të tilla dhe mbahen të tilla, nëse iu bën të ditur njerëzve se i vlerëson madje duke i përmendur specifikat e tyre dhe për të cilat ju jeni mirënjohës. Disa të vlerësojnë edhe për gjera shumë të vogla, kur ato i duken edhe të pa nevojshme, theksoj se këto kanë vlera shumë të mëdha në mirëkuptimin dhe respektin

njerëzor, por ka raste kur njeri ka bërë një punë shumë të mirë apo të madhe dhe nuk i ka thënë njeri të lumtë dhe falenderim për atë që keni bërë. Durimi i Mokrarëve është i një cilësie të veçantë. Ky nuk është aftësi për të prituri, por një aftësi për të dhënë një qëndrim të mirë dhe sa më real, pra kanë durim dhe presin, por jo deri në finish. Është e rëndësishme që ankesat dhe mendimet e bisedave sidomos negative, të merren dhe vlerësohen me shumë seriozitet . Miqtë në Mokër fitonin, ashtu siç është që çdo gjë duhet të fitohet dhe kjo e merituar. Askush nuk të jep falas . Jeta dhe përvoja në Mokër ka treguar se duhet ta meritojmë çdo gjë që marrim. Nëse duam miq kanë thënë të parët duhet ti mbajmë të lumtur se përndryshe do të na largohet dhe na refuzojnë. Çdo gjë në Mokër që është jashtë rregullit ndreqet e rregullohet

nëpërmjet bindjes. Bindja është detyra parësore e secilit. Bindja është një gjë e arritshme, ajo mbyll rrugët për veprim të këqija dhe hap një rrugë e dritare të pastër drejt qellit pa re. Në jetë mos bindja është frutë i një mendimi të gabuar. Mirë njohjen le ta presim, le te mos shqetësohemi për mungesën e saj. Të mos harrojmë se Jezuesi, shëroi 10 vetë me librozë brenda një dite dhe nga këta vetëm njëri e falënderoi. Pse duhet të presim më shumë mirënjohje, nga ç'mori Jezuesi? Të mos harrojmë se mënyra e vetme për të gjetur lumturinë nuk është duke prituri mirënjohjen, por duke dhënë, si pasojë e kënaqësisë që të jep ai veprim që bëre. Të dashur Mokrarë, të mos harrojmë se mirënjohja është, një tipar i kultivuar. Pra nëse duam që fëmijët të jenë mirënjohës, duhet t'i përgatitim ata që të jenë dhe të trashëgohen të tillë në breza.

## MOKRARËT JANË VETVETJA NË JETËN E TYRE

Nga Zabit CUKU

Mokrarët gjithmonë, kanë këmbëngulur që të jenë vetvetja. Mësojnë fëmijët, që çfarë do që të ndodhe, gjithnjë të jenë vetvetja. Autori Anxhelo Pratika ka theksuar: "Nuk ka njeri më të trishtuar sesa ai që shpirtet ndryshe nga ç'është". Gjëja më e mirë është që njerëzit të cilët hiqen sikur janë dikush tjetër, t'i largosh sa më shpejt që të jetë e mundur.

Gabimi më i madh që bëjnë njerëzit kur bisedojnë është se nuk janë vetvetja. Por kjo nuk ndodh në krahinën e Mokrës.

Flasin lirshëm dhe bisedojnë sinqerisht. Secili është vetvetja, një shkrimtar ka thënë; "S'mund të shkruaj një libër në nivelin e Shekspir, por mund të shkruaj që të jetë i imi"

*Dagllas hallah, e ka dhënë në formën e poezisë, si më poshtë.*

*Nëse s'mund të jesh pishë, në majë të kodrës,*

*Ji drizë në luginë, por ji.*

*Nëse s'mund të jesh kaçube, ji një fije bari,*

*Që ndonjë rrugë më të gëzueshme ta bësh*

*Në se s'mund të jesh rrugë thjeshtë ji shteg*

*Nëse s'mund të jesh diell, ji si yll*

*S'është madhësia matëse që fiton e humbet*

*Ji më i miri, sido që të jesh !*



ME RASTIN E 14 VJETORIT TË GAZETËS "MOKRA"

# Gazeta "Mokra," ka vendin e vet, në informacionin që u jep lexuesve

Nga Zenun FERRO  
Zabit CUKU

Më 25 mars 1999 doli numri i parë i gazetës "Mokra" me kryeredaktor Flori Slatinën, dhe antarë Haki Balliu, Dilaver Balla, Dylber Mani, e tjerë. Dy muaj më vonë kjo gazetë mori në gjirin e vet zotin Zabit Cuku, Zenun Fero, Llazi Tona e shumë të tjerë.

Ajo u rrit gradualisht, e ka justifikuar veten si gazeta e plotë. Në radhe me të tjerat edhe mbi ato lokalet. Po në vazhdim kësaj gazete ju radhitën edhe të tjerë Mokra e Pogradecarë si Istref Haxhillari, Bujar Balliu, Koço Pihoni, Sami Leka, Fari Muça, Isa Gorica, Shefki Balliu, Pasko Vako, Rahman Xhaferllari, Astrit Rrapce Eduart Belegu, dhe deri tek "Mokrari" Tomi Mato, Kristaq Nanushi e shume e shume të tjerë.

Më 25 mars 2013 gazeta mbushi 14 vjet, ky përvjetor u festua në Tiranë në degën e Shoqatës "Pelioni" në Kombinat. Në takim morën pjesë, Kryetari Shoqatës "Pelioni" Zoti Pëllumb Zade, Kryeredaktori gazetës "Mokra" Zoti Flori Slatina, anantë Zabit Cuku, Sami Leka, dhe nga dega e Kombinatit Bujar Qyrku nga Shpella, kryetari i degës, Aris Dulbaku edhe organizatori i takimit të këtij përvjetori, Gezim Sherri nga Losniku, Ramis Mokëri nga Senishti, Enver Gjera nga Shpella, Fuat Hoxha nga Kotodeshi, Haki Storellari nga Çezama e Madhe, Agron Durbaku nga Katjeli.

Ishin ftuar edhe Istref Haxhillari e Bujar Balliu por për arsye shërbimi nuk arritën të merrnin pjesë por dërguan urimet dhe përshtetjet e tyre. Takimin e hapi zoti Aris Dulbaku i cili vlerësoi punën e bërë në këto vite nga stafi dhe gazeta Mokra. Në vazhdim foli kryetari Shoqatës Pëllumb Zade, flori Slatina, Zabit Cuku të cilët vlerësuan dhe prezantuan punën 14 vjeçare edhe nëpërmjet një albumi fotografik të pasur nga viti i parë i themelimit të gazetës "Mokra" dhe aktivitetet të tjera në këto vite. Takimi kaloi me dollinë e traditës Mokrare ku pa këto rite të rakisë nuk mund të quhesh se je mokrar.



Në këto 14 vjet gazeta "Mokra" vazhdon punën dhe aktivitetin e saj, vazhdon edukimin e lexuesve të cilët i ka patur në tre grupe. Grupi i parë, kanë qenë ata që i besojnë nga ato që lexojnë, grupi i dytë kanë qenë ata që nuk i besojnë nga ato që lexojnë, dhe grupi i tretë ata lexues, të cilët dinë të sillen në mënyrë kritike më atë që lexojnë dhe në përshtatje me këtë nxjerrin konkluzionet e tyre.

Grupi i parë është më i madhi, paraqet pjesën më të gjerë, janë të prirur të lexojnë. Ndërsa grupi i dytë është më i vogli, përbëhet nga lexues të grupit parë, por ndodhen të zhgënjyer dhe nuk besojnë asgjëje, deri sa kjo është shkruar vetëm në gazetë. Këta lexues janë shumë të vështirë, sepse ata janë me prije mosbesuese, edhe atëherë kur fjala është për vetveten. Grupi i tretë i lexuesve është më i vogli, përbëhet nga intelektualë të zhvilluar shpirtërisht, të cilëve dhe vetitë e lindura dhe edukimi u kanë lehtësuar mundësinë e mendimit të pavarur.

Rëndësi më të madhe merr pikërisht grupi i parë i lexuesve

të gazetës "Mokra" më i madh në numër. Njerëzit marrin mbi vete angazhime, vetëm atëherë kur ata veprojnë jo vetëm nga detyrimi, por edhe nga bindja, me vetëdijen e plotë të domosdoshme së këtyre hapave konkrete. Shoqata "Pelioni" krijoi dhe nxori gazetën "Mokra" e cila ka vazhduar për 14 vite rresht dhe do të vazhdojë. Organizimi, funksionimi i saj ishte i ngadalshëm por i vendosur për të ecur përpara, pavarësisht mundësisë dhe mjeteve financiare të cilat kanë qenë jo të lehta. Përkrahësit e gjerë, dhe disa intelektualë të mokrës e më tej dashamirës dhe të aftë, si Flori Slatina, Haki Balliu, Istref Haxhillari, Zenun Fero, Llazi Tona Zabit Cuku e të tjerë ja kanë arritur qëllimit fillestar duke ecur dhe u përpjekur për të mos u ndalur. Udhëheqësi pavarësisht vullnetit që ka, duhet të jetë edhe i aftë për të realizuar atë vendim, e iniciativë që e fillon dhe ta vazhdojë deri në realizimin e saj. Një nga nismëtarët shpesh thekson: "e po ja ta nxjerrim dhe këtë numër se më vonë kështu se çdo

bëhet" por kjo ishte kur kemi qenë në vështirësi jo për shkrime dhe materiale se sa për mbështetjen financiare. Në këtë përvjetor falënderojmë shumë të gjithë ata që kanë sponsorizuar sado pak në këtë gazetë informuese në krahinë e Mokrës e më gjerë.

Shoqata dhe stafi i gazetës nuk kanë patur mjete dhe anëtarë direkt me pagesë të caktuar apo te emëruar, ka vepruar dëshira iniciativa e secilit për kontribuar me shkrime, informacione, me mjete financiare, pra ishte dëshira dhe dashuria për të kontribuar. Për tu informuar lexuesi nga disa nuk është parë pasuria ka apo ska, dhe të kontribuoj, jo nga analiza e këtyre viteve rezultoi se kanë kontribuar më shumë ata me shtresa e fuqi nën një nivel mesatar jetese, me pensione, të pa punë, por kanë shprehur atë shpirtin dhe dashurin për gazetën "Mokra" Ju faleminderit!. Në fillim po dhe me vonë kishte vështirësi transporti, shpërndarja. Por kur është lexuar dhe e kuptuar është shprehur edhe habi se kush janë këta, nga e nxjerrin, kush është stafi i saj e

tjera. Në këto vite jo të pakta është rritur interesi, kërkesa, rritur cilësia e informimit në krahinë e mokrës po edhe më tej.

Jo çdo gjë ka qenë perfektë por ka patur edhe kritika e sugjerime te cilat janë pranuar nga stafi duke u përmisuar dhe korrigjuar në vazhdimësi. Shumë nga lexuesit kanë dhënë vlerësimet, mirënjohjen, dhe falënderimet për stafin dhe gazetën.

Nëpër mjet gazetës edhe disa nga botuesit e botimeve të ndryshme të librave të cilët ne i urojmë, i falënderomë duke u mbështetur, për marrjen apo dhënien e informacione të sakta e reciproke si Haki Balliu, Istref Haxhillari, Bujar Balliu, Daut Kroi, Llazi Tona, Zenun Fero e tjerë. Shkrimet dhe botimet ka qenë ekuilibruese, jo godiste, por informuese, për publikun dhe lexuesin e saj. Tendencat e kundërshtit jep pamje të gabuar dhe prit goditjen më pas e cila hap debate jo reale.

Midis shumë medjave vizive gazeta mbetet në çdo kohë në dorë dhe në mendje, e shikon e lexon apo e pasuron pra kjo është kryesorja për shtypin e shkruar, për historinë shifrat e fakte të pa kundërshtueshme. Ne me gazetën "Mokra" kemi pjesën në vendin e vet që na takon ta mbajmë të ecim më tej ta pasurojmë dhe të informojmë sa më gjerë më realitetin mokrar.

Gazeta forcon demokracinë rrit nivelin në njohjen, trashëgiminë e historisë, rrit kulturën tek të rinjve dhe e trashëgon në breza. Këtë duhet ta thotë lexuesi të cilin me këtë rast ne i urojmë më shumë punë, më shumë lexues dhe më shumë mbarësi në ecjen përpara të gazetës "MOKRA" Urime, e suksese stafit në përvjetor të tjerë.

Për të kultivuar një gjendje emocionale që na sjell paqe dhe na çliron nga shqetësimi duhet të mos imitojmë të tjerët, gjeni veten dhe jini vetvetja. Një proverb kinez thotë: "Në dorën që të jep trëndafila, gjithnjë mbetet pak aromë".

Mokrarët janë dëgjues të mirë dhe u japin bisedave kuraja që të flasin për vete. Ata u japin kënaqësi të tjerëve dhe më të njohur në biseda të ndryshme. Njeriu që mendon vetëm për veten e vet do të jetë mjeran. Kurse mokrarët u shërbejnë të tjerëve, janë mikpritës dhe gjejnë gëzimin e të jetuarit. Çdo ditë bëjnë gjëra të mira. Hallet mokrarët i qajnë me dikë, tek i cili kanë besim. Këtë mjekët dhe psikologët e quajnë katersis. Bluarja e halleve me mend dhe mbajtja e tyre brenda vetes shkakton tension të madh nervor. Të gjithë duhet t'u flasin të tjerëve për hallet e tyre. Mokrarët nuk flasin, ndaj kush t'i dalë përpara, për hallet që kanë. Ato zgjedhin dikë, tek ai që

kanë besim dhe kërkon të dëgjojë ato që do ti thotë ai. Nuk ndalen gjatë te mangësitë e të tjerëve.

Kanë qëndrim të ekuilibruar i cili është më i miri. Nuk kemi përse t'ia hapim jetën tonë kujtdo që takojmë, duke i dhënë kështu shans për të na thyer. Marrëdhëniet njerëzore i zhvillojnë deri në një masë të caktuar. Mokrarët thonë vetëm fjalë të mira të cilat janë shëruese. Zemra e të urtëve e bën të matur gojën e tyre. Fjalët e ëmbla janë si mjalti, ëmbëlsi për shpirtin dhe ilaç për kockat. U mësojnë fëmijëve, më shumë me anë të shembullit sesa të shfuqizosh fjalët me sjelljen e keqe.

Mokrarët janë realistë për çdo gjë. Nuk janë ziliqarë që e bën njeriun të sillet në mënyrë të pashpirt dhe të vrazhdë me raste.

Këto cilësi të mokrarëve e rrisin më tej krenarinë e tyre që janë realist dhe vetvetja.



## Nis rikonstrukcioni i rrugës së Velçanit 3.07 km e gjatë



Ka nisur në komunën e Velçanit rikonstrukcioni total i rrugës, me gjatësi 3 km e 70 m. Aktualisht, sipas kryetarit të komunës z. Ilija Mani, "kanë përfunduar muret mbajtëse, të cilat janë punuar nga muratorët e zonës, të cilët shquhen si mjeshtrë zonalë. Është për t'u përmendur kontributi i të gjithë banorëve për lirim e rrugës dhe zgjerimin e saj". Rikonstruksioni i rrugës do të bëjë të të kthehen shumë familje e vëmendja të kthehet aty, në vendlindje. "Kanë filluar të kthehen shumë banorë dhe të ndërtojnë shtëpi të reja. Është kthyer besimi se një jetë më e mirë po troket".

Ndërtimi i rrugës do të mbarojë deri në fund të këtij viti.

## Të jetosh në heshtje

Nga Lavdërim Miminllari

Shoqëria jonë demokratike e civilizuar dhe e hapur sot men doj sepse ka ecur. Për këtë është fakti se çdo kush nga ne ka lëvizur në Europë apo kanë të afërmit që jetojnë jashtë me një kulturë e sjellje demokratike. E për këtë çdo kush shkon nga qyteti jonë në Ohër e shikon rregullin e pastërtinë që e karakterizon apo sjelljen qytetare. A mendojmë ata janë më të mirë se ne, them jo. e kjo të shpie në kulturën e zbatimin e Ligjit apo dhe të kërkesës së të drejtës. Qytetari që ka kulturë sot 23 vjet në demokraci nuk kupton që demokraci do të thotë zbatim ligji. Edhe unë i dashur lexues mu desh të merrja pjesë si çdo qytetar në mbl.ek.Bashkiak ku jepej buxheti 2013. Duke ditur ligjin që çdo qytetar të marrë pjesë nuk kuptova se qytetarët vetëm dëgjonin e shikonin, më çudit se këshilltarët të ndarë të majtë e të djathtë. Problem që diskutohej ishte taksat e Buxhetit 2013. Po ju them çso kush mund të marrë pjesë. Pati ngritje taksa, lojra fati, taksa të objekteve shtetërore, ulje taksash në turizëm, biznes e ngritje taksa të ujit, për të cilën taksat bëhen nga 4.5 m<sup>3</sup> 30 lek dhe 4.5 m<sup>3</sup> 66 lek. Po dhe kanalizimet ritur, nuk i referohem ngritjes se është në listë pagesën e ujit të Janarit. Për çdo familje kriza po vjen e po futet në çdo familje si Greqia në krizë. Italia po. Cdo njeri hesht, qytetarët ankojnë në tavolina apo në sebepe e jo ku duhet kërkesë. Fushata po afrohet si të majtë e të djathtë thonë ulim taksat, unë them kur heshtete rëndon mbi qytetarin. Në televizionet flasin po në realitet ka ngritje kur gjysma e qyteteve ska kanalizimet të mbaruara, po më dukey c duhen lek bashkisë dhe rëndon mbi qytetarët kur uji del nga mali fati c këtij qytetti që uji të jetë me kosto shumë të ulët. Këshilltarët nuk flasin por

miratojnë, kur çdo këshilltar duhet të japi llogari para zgjedhësve kur kjo nuk bëhet po mjafton këshilltari të marrë atë pagë e të ketë ndonjë të punësuar pjestarë familje apo të afërm apo të bëjë ndërtim me leje nga bashkia e nuk flet dot e jo për taksat që ngrihen jo e jo. thonë që I ka ngritur bordi po aprovimi I kujt është them unë që thotë miratohet, pse nuk thuhet kundërshtohet nga Këshilli bashkiak. heshtja është s eparësisht se ke prek po bie mbi të gjithë ne kujt më shumë e më pak.

Ashtu siç është energjia elektrike që mendoj se ka vend për abuzim dhe korrupsion që kjo fjalë ndodh në shumë raste, në kontrollin e çdo leximi I është besuar një personi I cili bën sit ë dojë , kë mund të ketë shok apo mik. Ju jap një shembull: A keni parë ndonjë lexim të ndonjë punonjësi? Jo. sa paguajnë, jo mendoj se ka vend për një ngritje zëri. Sot pallatet kanë nga një që është I zgjedhur I pallatit. E mendoj se leximi të bëhet në praninë e një personi sepse mjafton tu jap një shembullpersoni në Greqi. Ai paguan lekë apo deri në fatura shuma të larta. Cdo kush hesht se mendojnë që kjo të shpie deri tek cmimi 7 ... ose 13 ose lek apo deri tek 20 % TVSH. Unë mendoj si qytetar përse duhet të paguaj si biznes në 40.00 lek duhet të paguaj 8.00 TVSH apo dhe televizorin shqiptar kur unë nuk e shikoj po kam një kabllor apo Dixhital. Përse duhet të paguajë qytetari? E kjo të shpie atje në heshtjen po c them ligji që zbatohet për të gjithë njëllor, mendoj se kjo bën atë që qytetari hesht se askush se dëgjon, mjafton të buzëqeshi këtë apo atë parti. Po mbi supet e tij rëndojnë çdo gjë që ngrihet në taksa. Mendoj që qytetari apo çdo kush nga ne duhet të ngrejë zërin për atë që paguan se çdo gjë rëndon në familjen e çdokujt, të atij që është me asistencë, që merr përkrahje të atij pensionisti të çdokujt që ka një biznes, shtëpi në falimentimin e tij.



## RIFILLOJNË PUNIMET NË RRUGËN QUKËS-QAFË PLOÇË

Ridvan Bode: Shkurtohet me 3 herë distanca mes Tiranës dhe Korçës

Përfundimi i autostradës Tiranë-Elbasan i çel rrugë një tjetër projekti madhor në kuadrin e modernizimit të infrastrukturës dhe shkurtimeve të distancave mes qyteteve të vendit. Bëhet fjalë për rrugën Qukës-Qafë Ploçë një aks tërësisht i ri i cili shkurton në mënyrë të ndjeshme distancën mes Tiranës dhe Korçës dhe gjithë juglindjes në më pak se 1 orë e 30 minuta nga 4 orë që është aktualisht. Ministri i Financave, Ridvan Bode u shpreh se punimet nisin së shpejti, ndërsa vlerësoi se ky investim madhor do të sjellë më afërt tregjet dhe njerëzit, ul kostot dhe zhvillon në mënyrë të ndjeshme biznesin. "Pak ditë më parë ju bëra me dije miratimin nga Banka Islamike për Zhvillim të financimit në shumën 125 milion dollarë të rrugës Qukës-Qaf Ploçë. Më poshtë po ju jap disa pjesë të projektit të kësaj rruge e cila pas përfundimit së shpejti të rrugës Tiranë-Elbasan, do jetë një nga projektet infrastrukturore me madhore në vend, qe do ta afroje juglindjen me kryeqytetin në një kohë



2-3 herë më shpejt se sot. Korça nuk do të jetë më shumë se 1 orë e 30 min apo Pogradeci rreth 1 orë, Kolonja 2 ore e 30 min dhe Devolli 1 ore e 45 min. Një investim qe sjell më afër tregjet dhe njerëzit, ul kostot dhe zhvillon biznesin", u shpreh Bode. Banka Islamike ka dhënë miratimin për financimin e rrugës Qukës-Qafë-Ploçë, në fund të muajit shkurt të këtij viti, duke i mundësuar kështu qeverisë vijimin me procedurat e tjera që lidhen me këtë projekt. Paketa e financimit nga Banka Islamike për Zhvillim llogarit 125 milionë dollarë. Më herët Banka Islamike për Zhvillim ka financuar pjesën më të madhe të kredisë që qeveria përdor akoma dhe sot për ndërtimin e autostradës Tiranë-Elbasan.

## COHEN: DO TË INVESTOJMË ME TEKNOLOGJITË MË TË MIRA IZRAELITE NË FUSHËN E BUJQËSISË

Ambasadori Izraelit i akredituar në Shqipëri, David Cohen, ka zhvilluar takime me përfaqësues të pushtetit vendor në Prrenjas, si edhe në komunën Qukës

Ambasadori Izraelit i akredituar në Shqipëri, David Cohen, ka zhvilluar takime me përfaqësues të pushtetit vendor në Prrenjas, si edhe në komunën Qukës, ku dhe ka realizuar një bashkëbisedim edhe me biznesin e kësaj bashkie dhe komune. Në fjalën e tij Cohen është ndalur tek bashkëpunimi në fushën e ekonomisë mes dy vendeve dhe nuk ka lënë pa përmendur resurset e mëdha natyrore që ka Shqipëria, në veçanti atë të turizmit.

"Ne synojmë të zgjerojmë bashkëpunimin në fusha të ndryshme, por në veçanti në fushën e ekonomisë", iu drejtua Cohen biznesmenëve të pranishëm në këtë takim, i cili u organizua në ambjentet e Bashkisë Prrenjas. Duke u ndalur tek kriza globale, Cohen tha

se " Izraeli nuk është prekur nga kjo krizë globale", ndërsa shtoi se shteti i tij është i interesuar që të investojë në disa fusha në Shqipëri.

"Në fushën e bujqësisë do të kontribuojmë me eksperiencën dhe teknologjitë më të mira izraelite dhe doja t'ju thoja se një kompani izraelite ka shprehur interes për të investuar në minierat e Shqipërisë, në veçanti në atë të Prrenjasit", tha Cohen.

Aktualisht në Shqipëri janë 45 kompani izraelite, të cilat kanë investuar në fusha të ndryshme.

"Shqipëria është një vend shumë i bukur për të thithur turistë dhe turizmi është një nga fushat kryesore ku mund te kushtoni vëmendje të veçantë", tha diplomati izraelit David Cohen.



## RRETHI ME SHKUMËS

Nga **BEDRI BLOSHMI**

**P**ara shumë vitesh në Francë, me sa më kuj tohet në një familje grabitet një fëmijë. E gjithë familja është shumë e tronditur dhe u vunë të gjithë në kërkim të fëmijës. Kaluan vite e vite në kërkim, por pa asnjë rezultat apo shpresë për gjetjen e fëmijës së grabitur. Më në fund pjestarët e familjes vendosën ta ndërpresin kërkimin, përveç nënës së fëmijës së humbur. Ajo vendos ose ta gjej fëmijën, ose do sakrifikoje veten, Ç' më duhet jeta mua, pse duhet të jetojë pa fëmijën tim! Kushedi se ku është? Kush I jep të hajë, kush i jep ujë të pijë? Ajo që ma ka grabitur a ma trajton si fëmijë e vetë, nëse ka? Nëse nuk ka ç'fajë kam unë? Unë dua fëmijën, është i imi e kam të zemrës, e rrita me shumë mundime një copë mishi dhe tani ja vjen një ditë e ta marrin. Oh, shpirt I nënës ku je, mos qaj o shpirt I nënës do të gjej ku do që të jesh. O Zot të lutem ma kthe fëmijën, të përgjohem, mos ma merr shpirtin pa e gjetur shpirtin tim! Kurrë s'kam për të pushuar së kërkuari, natë e ditë deri sa ta gjejë është fëmija im ku e kam, kush ma mori o zot të lutem.

Nëna merr rrugët si e marrë e me shkop në dorë, flokët të lëshuara mbi fytyrë e me sy të çapluar, qante ulërinte pyeste këdo që takonte. Ikte si e marrë fshat më fshat, natë e ditë pa pushim. Thërriste sa kishte në kokë kush e ka parë një fëmijë të vogël. Më ka humbur mua, ma kanë grabitur, më ndihmoni të gjej fëmijën. Përrua më përrua e rrugicë më rrugicë, diku në një fshat në bisedë e sipër, me një plakë i thonë se një grua e atij fshati që s'kishte patur fëmijë kurrë, e kishin parë të dilte shpesh me një vajzë të vogël përdore dhe shpeshherë i bërtiste apo e qëllonte. Kur dilnin në fshat të gjithë e dinte që s'e kishte fëmijën e vet. E gjora nënë e ndërpret bisedën dhe shkon atje ku banonte fëmija.

Mbasi e pa fëmijën e përqafoi, puthte dhe qante. "Nëna" e zonja e shtëpisë, e shikonte e habitur dhe gjithë inat e me të thirrur ja rrëmbeu fëmijën nga kraharori. Të dyja gratë thërrisnin dhe bërtisnin me fjalët që nxirrnin nga goja njëra thoshte është imja, tjetra thërriste se është imja. Përfundimisht gratë iu drejtuan gjyqit ta zgjidhë këtë problem. Ditën e gjyqit filloi séance dhe gratë bërtisnin dhe thërrisnin, sa s'e merrte vesh i pari të dytin. Fëmijën e mbante përdore "nëna" e dytë. Dha e mori gjyqtari e pamundur ta vendoste se e kujt ishte fëmija. Seancën tjetër gjyqtari vendosi që fëmijën ta merrte ajo që e kishte paraqitur në gjyq. Çështja vajti në shkallën tjetër, por dhe kjo gjykatë nuk e ndryshoi vendimin sepse fëmija rrinte me atë që e kishte rritur dhe nënën

biologjike nuk e njihte ndaj nuk i afrohej. Çështja shkoi në gjykatën e lartë gjyqtari i cila caktoi dhe ditën e seancës. Në këtë seancë të dyja gratë thërrisnin është imja thoshte njëra është imja ja priste tjetra. Dha e mori gjyqtari por qe e pamundur të merrte vesh me të dyja gratë. U mbyll seance dhe u caktua seance tjetër e gjyqit. Erdhi dita dhe u paraqitën të dyja gratë, njëra me fëmijë përdore. I pyeti dhe njëherë gjyqtari, do merreni vesh me njëra-tjetrën zgjidhni këtë problem se kush e ka fëmijën apo jo. Si njëra dhe tjetra thërrisnin është e imja fëmija, jo është e imja ja priste tjetra. E gjithë salla e gjyqit me të ftuar ngeli e shtangur se s'po merrte rrugë zgjidhje problem.

Atëherë, ndërhyri gjyqtari gjithë inat, mirë se e zgjidhim unë këtë punë. Ngelet që të kënaqeni të dyja, fëmijën do e ndajmë përgjysëm. Nëna biologjike filloj të qajë e thërrasë për vendimin që do merte gjyqtari tjetra mbante fëmijën për dore.

Në mesin e sallës, gjyqtari bëri një rreth me shkumës. E mori fëmijën, e vendosi brenda rrethit dhe i urdhëroi të dyja gratë ta kapnin njëra nga një dorë dhe tjetra nga dora tjetër. Ndërkohe mori një shpatë dhe e ngriti mbi kokën e fëmijës, gati për ta ndarë përgjysëm. Në këtë kohë nëna biologjike e lëshoi dorën e fëmijës duke thirrur mos e ndaj, fëmija është i imi po le ta mbajë ajo, mos e ndajë më dysh. Ndësa gruaja tjetër e tërhiqte fort nga krahu.

Atëherë gjyqtari vendosi: Lëshoje fëmijën se nuk është i joti, I drejtohet gruas që e tërhoqi fëmijën sepse fëmija është i kësaj tjetres që nuk do të ndahet për gjysëm. Po në Shqipëri, a do të gjendet vallë ndonjëherë se ku e ka follenë drejtësia? Nëna biologjike me fëmijën e saj për dore duke u larguar për në shtëpi duke falenderuar gjyqtarin për drejtësinë e dhënë.

## Ajaz Bego, me vitet e respektin mbi supe

**A**jazi shkon rrugës ngadalë si të kujtojë në çdo hap udhët e gjata që ka përshkruar për të ardhur deri në këto vite të qeta. Ai ka lindur më 19 tetor të vitit 1934 në fshatin Slabinjë të Mokrës së Poshtme. Rrjedh nga një familje e madhe me shumë miq, fëmijë, punë e pasuri. Njohu dhe bashkëjetoj me dy gjyshërit Kadriun dhe Qamilen, me babanë Dilaverin dhe nënën Sheqeren, me xhaxhanë Ramizin dhe të shoqen e tij Hamidenë. Që të gjithë të sjellshëm, të dashur me fëmijët.

Kjo familje jetonte mirë sipas kohës kishte 50 krerë bagëti, 50 dynym tokë, 1 lopë, 1 pendë qe dhe 1 mushkë. Kadriu kishte 3 fëmijë, 2 djem dhe 1 vajzë, Dilaverin, Ramizin dhe Rubien. Dilaveri ishte martuar me Sheqeren, të bijën e Maliq Kullolit nga Goliku. Ky çift lindi 5 fëmijë, Ajazin, Rexhepin, Behijen, Xhevatën dhe Ruzhdien. Nëna fëmijëve vdiq në vitin 1946 në moshë të re dhe fëmijët jetimë të u rritën dhe u martuan nën kujdesin e gjyshërve, babait, xhaxhait dhe Hamidesë.

Babai Dilaveri, duke qenë në moshë akoma të re u martua me Reshidenë, vajza e Rustem Balliut. Ky çift lindi dhe 5 fëmijë te tjerë, të gjithë djem, Fetiu, Kalemi, Safeti, Zeneli dhe Berti.

Vitet e fëmijërisë e mësuan Ajazin të jetë i kujdesshëm, të dojë njerëzit e vendin, të mësojë sa më shumë në shkollën e vogël filllore krye fshatit. Dhe filloi të thurë ëndrra, por ato harroshin shpejt se i duhej të rraskapitej pas tufës së bagëtive që duhej të çonte në kullotë. Kjo deri sa derisa shkoi ushtar në vitin 1955. Ushtrinë e kreu në Shkodër dhe në Elbasan. Në fund të vitit 1956 lirohet nga ushtria dhe vjen përsëri në fshatin Slabinjë. Pas ushtrie, si gjithë moshatarët ai iu bind familjes dhe u martua me Feriden, të bijën e Harun Elezit nga Velçani i Mokrës, me të cilën jeton edhe sot. Katër fëmijë, dy djem dhe dy



vajza janë jo vetëm gëzimi i tij i pafund, por dhe niprit e mbesat e bëjnë që të mos i ndiejë mbi supe vitet e mbi zemër shqetësimet e jetës.

Jeta aktive duket se sot ka zenë vend në sytë e mençëm mbushur plot gjallëri. E kujton të freskët ditën kur u largua familjarisht në fund të vitit 1957 për në fermën e Sukthit në Durrës. Atje ai punoi tre vjet si punëtor dhe e brigadier në frutikulturë. Në fund të vitit 1960, për nevoja familjare largohet nga ferma dhe vjen me gjithë familje përsëri në fshatin Slabinjë. Në atë kohë shkon për të punuar në stabilimentin e sharrave Bishnicë.

Atje fillimisht emërohet magazinier i lëndës drusore dhe faturist i automjeteve. Në vitin 1963 largohet nga kjo detyrë dhe emërohet normist në sektorin Rovje të rrethit të Gramshit, i cili në atë kohë ishte në vartësi të stabilimentit të Bishnicës dhe ishte sektori më i madh i shfrytëzimit të lëndës së drurit. Ajazi, në detyrën e normistit dallohet për punë të mirë dhe në fund të vitit 1963 emërohet Përgjegjës i sektorit të Rovjes. Nga viti 1963-1968 që kreu këtë detyrë Ajazi merr në Rovje edhe familjen dhe e shoqja e tij punësohet kuzhinierë. Gjatë kësaj kohe u dha urdhër nga Ministria e Industrisë që të shtohet aktiviteti i shfrytëzimit të pyjeve në rrethin e Gramshit dhe për pasojë në fund të vitit 1968 stabilimenti i Bishnicës ndahet në dy stabili-

mente, atë të Bishnicës dhe të Rovjes. Ajazi emërohet përgjegjës i stabilimentit të Rovjes. Përveç detyrës së përgjegjës të stabilimentit, nga ndërmarrja e përpunimit Pogradec iu ngarkua detyrë që të ngrinte edhe dy sektorë të tjerë shfrytëzimi në zonën e Gramshit, të Gribës dhe të Lukovës. Gjatë kryerjes së kësaj detyre, Ajazi dallohet jo vetëm për realizimin e planit por edhe sjellje shumë të mirë me punëtorët.

Në vitin 1972, të dy stabilimentet bashkohen përsëri, duke u emërtuar stabilimenti i sharrave Bishnicë. Ajazin e emëruan drejtor të këtij stabilimenti të madh, detyrë të cilën ai e kreu me sukses.

Me emërimin në Bishnicë, Ajazi u stabilizua aty edhe me familje. Në vitin 1978, Ajazi largohet nga Bishnica dhe emërohet kryetar i kooperativës së Velçanit, kooperativa më e madhe e zonës së Mokrës së Poshtme. Edhe në këtë detyrë ku Ajazi punoi gjashtë vjet, u dallua për punë të mirë dhe mbajti me njerëzit marrëdhënie të ngrohta. Kur i kujton ato vite mbushet me dhimbje për dashurinë më të cilën e rrituan njerëzit e mirë të Velçanit.

Në vitin 1984, Ajazi punoi një vit në ndërmarrjen mirëmbajtje rruga-ura, nga Goliku në Bishnicë e deri në Rovje e Ujin e Ftohtë.

Në vitin 1985 emërohet përgjegjës tregëtie në sektorin e Trebinjës ku punoi deri në vitin 1988, pastaj emërohet përgjegjës tregëtie në sektorin e Proptishtit ku punoi deri në vitin 1993 kur edhe doli në pension.

Me mendje të kthjellët ai nuk harron të kujtojë jo vetëm vete në një vend pune, por sidomos njerëzit me të cilët ka ndarë gëzimet, shqetësimet e hallet.

Por dhe ndihet mirë kur e përshëndesin në çdo hap që hedh. Është mirënjohja e viteve të punës me ndershmëri.

Ecën udhës për në fshatin Gështenjas ku jeton vitet e bardha të pleqërisë bashkë me të shoqen dhe u gëzohet viteve që vijjnë.

Korrespondenti i gazetës "Mokra"

## HOMAZH PER NENEN QERIME TORRA

Mësuam me dhimbje, se më 20 Mars u nda nga familja, miqtë dhe të afërmit, nëna e dashur dhe nderuar Qerime Ali Torra. U lind në Slatinë në vitin 1925. Fëmijërinë dhe rininë i ka kaloi në Rodokal, me familjen e saj.

Në vitin 1947 u martua me Ramadan Torrën. Pati punuar në kooperativën bujqësore që nga formimi i saj e deri sa doli në pension. Rriti dhe edukoi me punën e dhembshurisë e nënës tri vajza e dy djem, nipër e mbesa...

Në vitin 1969 i vdes bashkëshorti. Jeta e vuri para vështirësish të tjera që ajo i kaloi me sukses. Për fëmijët e saj ajo tashmë do të ishte jo vetëm nënë, por edhe baba. Në emër të shoqatës atdhetare e kulturore "Pelioni" ku biri i saj, mësuesi e poeti Maliq Torra, vepron aktivisht, e të gazetës "Mokra", u shprehim fëmijëve, nipërve e mbesave ngushëllimet



tona të sinqerta për humbjen e njeriut të tyre më të dashur.

I paharruar qoftë kujtimi i saj!

Llazi Tona, Istref Haxhillari, Bujar Balliu, Xhevahir Shtupa, Flori Slatina, Haki Balliu, Sami Leka

## Ngushëllim

Redaksia e gazetës "Mokra" dhe shoqata "Pelioni" ngushëllojnë përzemërsisht z. Haki Balliu, për humbjen e vëlait të tij të dashur, Livanit, i cili u nda nga jeta në muajin prill. Ngushëllimie i shprehim edhe familjes së të ndjerit, djemve, vajzës, nipërve e mbesave të tij. Z. Livan ka qenë një nga lexuesit e rregullt dhe pjesëmarrës në disa aktivitete të shoqatës sonë në Mokër. I paharruar qoftë kujtimi dhe emri i tij!

Zabit Çuku, Pëllub Zade, Zenun Fero, Istref Haxhillari, Bujar Balliu, Flori Slatina, Sami Leka etj



Z. Livan Balliu, gjatë një aktiviteti në Proptisht



ME RASTIN E 70- VJETORIT TË KRIJIMIT TË BATALIONIT PARTIZAN TË MOKRËS (17 MAJ 1943-2013)

# Jehona e çetave partizane në luftimet kundër armikut në Snosmi e Bulçar



Nga Llazi TONA  
Oficer i llogjistikës në pension

*“Heroi i popullit” Reshit Çollaku, komandant trim dhe i zgjuar që populli ynë ka nxjerrë nga gjiri i popullit të tij*



Reshit Çollaku

Pas luftimeve të suksesshme në krahinën e Vërçës, Jehona e Lanç-it u shtri gjerë në krahinën Bërzeshtës, Qukësit, Përrenjasit, Mokrës, Polisit, Gorës, Çërravë dhe Malit të Thatë. Lidhur me këtë, bën fjalë edhe një Buletin që mban datën 9 shkurt 1943 mbi rëndësinë e luftimeve kundër armikut në zonën Snosm-Bulçar: “Fillim i vitit 1943, që po bëhej rit fitoresh i fuqive çlirimtare kundër horrdhive më barbare që kanë parë shekujt, duhej medoemos të mbyllej me fitore të bujshme dhe të armëve partizane në mal e Gramshit pas veprimeve të udhëhequr të forcave partizane. “Zëri i popullit” vlerëson gjithashtu lart rëndësinë e luftimeve të Snosm-Bulçar, ku ndërmjet të tjerave shkruan: “Çetat partizane kanë korrur një nga sukseset më të bujshme, një fitore që u ka me të vërtetë hije luftëtarëve zemëruanë, bijtë e shqipes mbajnë lart flamurin e Skënderbeut” (Zëri i Popullit Nr.12-14, shkurt 1943).

Çetat partizane të Gorë-Opar dhe Mokrës, pasi festuan me gëzim fitoren e re me njësitë guerile dhe me fshatarët përreth, më tre shkurt u kthyen nëpër zonat e tyre të veprimt, ndërsa partizanët e Mokrës ndenjën në Vërçë edhe disa ditë te tjera.

Ndërsa pushtuesit fashistë italianë nuk dinin si ta fshinin turpin e disfatës. Ata jo vetëm trillonin se “forcat partizane” në luftimet e Snosm-Bulçar kishin qenë mëse shtatëfishin e ushtarëve italianë, por gjoja paskëshin përdorur kundër tyre pra italianëve topa dhe mortaja. Për t’u hakmarrë, komanda e përgjithshme e forcave italiane shpërtheu reprezalje kundër disa fshatrave në afërsi të Gramshit. U dogjën më se 40 shtëpi, u masakruan 10 fshatarë. Pushtuesit fashistë italianë duke mos guxuar të hynte thellë në zonën e Vërçës vuri në veprim artillerinë dhe avionin duke bombarduar shtigjet nga mund të kalonin forcat partizane.

Në Mokër, po atë ditë, pushtuesit e përpoqën përsëri të depërtonin në krahinën e çliruar. Një repart milicësh mundi të shkonte deri afër Trebinjës, por sulmi i vrullshëm i partizanëve dhe fshatarëve e detyroi armikun të zbrapset pas një qëndrese të shkurtër, duke lënë mjaft të vvarë.

Pushtuesit italianë dhe shërbëtorët

e tyre disa herë u orvatën për të nënshtruar me zjarr Mokrën e pamposhtur. Me që nuk ia dolën dot mban, atëherë ata menduan të paraqiteshin tek mokrarët me mënyra të ndryshme.

Në janar 1943 komandant italiane dhe shqiptare të milicisë fashiste të Korçës i dërguan një letër parisë së Mokrës. Në të propozoj një marrëveshje, sipas së cilëve, në Mokër duhej të rimëkëmbeshin postat ushtarake. nga ana tjetër fashistët italianë zotoheshin të rindërtoheshin shtëpitë e shkatërruara nga lufta dhe të furnizonin fshatarët e Mokrës me ushqime dhe artikuj të tjerë të domosdoshëm.

Letra u muar në shqyrtim nga partizanët dhe këshillat nacionalçlirimtare dhe nga fshatarët e Mokrës. Si përfundim i një radhe kuvendesh popullore, të zhvilluara me frymë të lartë patriotike e

vendos ti dërgohej komandës së milicisë fashiste të Korçës, një përgjigje e cila u botua në “Zërin e Popullit”.

“Në çetat partizane dhe populli i Mokrës nuk mund të lejojmë që këtu në Mokër të vijë milicë rebelë, fashistë, ushtri me çfarëdo autoritet tjetër tradhtar ose italian qoftë”.

“Populli i Mokrës ka ngritur flamurin e lirisë të shenjtë dhe është i vendosur ta mbrojë me nder e me çdo kusht. Kërcënimet, intrigat ose premtimet që na bëjnë tradhtarët e barbarët fashistë, nuk na trembin kurrë ne, rrugën tonë

të shenjtë gjer në zhdukjen e barbarit fashist gjer në lirinë e plotë të popullit dhe të atdheut”

“Çeta partizane dhe populli i Mokrës mund të merren vesh me armiqtë vetëm, me grykën e pushkës dhe do të merremi vesh gjersa fashisti i fundit të jetë zhdukur fare nga faja e dheut” (Zëri i Popullit, Nr.15, shkurt 1943).

Një dëshmi tjetër e heroit patriotik që ngjalli veprimet e çetave partizane në Mokër dhe rrethina ishte mbledhja popullore në Krushovë të kësaj krahine.

Sipas një artikulli të botuar në “Zërin e Popullit” Nr.11-12 Janar 1943 ndërmjet të tjerave shkruhet: “Në Krushovë të Mokrës fshatarët kanë dalë të gjithë në sheshin e fshatit të presin ushtrinë popullore, që hyri triumfalist. Në mes të fshatarëve qëndron një plak i moçëm i cili në duart e tij mban një flamur të vjetër. Komandanti Reshit Çollaku u flet fshatarëve, u shpjegon mizoritë që heq populli shqiptar nga zaptuesi si fashist. Në mbarim të fjalimit, plaku me flamur afrohet dhe i thotë komandant Reshitit: “Merreni këtë flamur se e meritoni, është flamuri tridhjetëvjeçar, është flamuri i çetave të vjetra shqiptare. E mbaja në syndyqin tim, sot erdhi dita ta nxjerr dhe t’ua dorëzoj bijve tanë heroikë. Komandanti rroku flamurin, e puthi dhe i tha do ta mbajmë. “Dhuratën e shenjtë që na dhe do ta mbajmë kurdoherë të papërkulshëm, flamur i çetave është në duart të sigurta. Mbi atë fushën e kuqe ku janë shkruar fitoret e prindërve tanë, ne, bijtë e tyre, do ta shkruajmë me gjakun tonë dëshirën e përjetshme të popullit tonë çlirimin e vërtetë të Shqipërisë”.

Çlirimi i krahinave të tëra, midis tyre dhe i Mokrës, nga çetat partizane, u përshëndet me një trakt dhe nga Qarkori i Korçës: “Sot që postat, komunat e patrullat fashiste nuk përlyejnë më tokën kreshnike të Mokrës, mbretërojnë në këtë vend drejtësia, bashkimi, qetësia dhe liria e plotë. Sot gati po zhduken të gjitha vrasje te grabitjet. Sot jeta dhe pasuria mbrohen dhe sigurohen nga çeta partizane dhe këshillat nacionalçlirimtare. Mokra është e tëra vëllazërore dhe e bashkuar. Populli i Mokrës është i hedhur i tëri ne LANÇ-ri dhe mban lart të paprekur e të paepur flamurin e lavdishëm të Skënderbeut” (AOP Trakt i Komitetit Qarkor të Partisë për Korçën. Shkurt 1943).

Na javën e parë të muajit maj 1943, Çeta partizane e Mokrës goditi një autokolonë armike me ushqime. Në këtë aksion partizanët kapën 65 kg sheqer, 160 kg misër dhe u a shpërndanë fshatarëve të Mokrës. Në këto luftime u daluan Jovan Gjika, Jonuz Misliu, Lufti Kullolli, Xhafer Spahiu, Kristo Divjaka.

Krahas sukseseve të luftës së armatosur, pushteti i këshillave nacionalçlirimtare në krahinën e çliruar të Mokrës dhe Vërçës, në rend të ditës u vu organizimi i kryengritjes së Përgjithshme.

Kjo u shfaq me shndërrimin e çetës







Çeta e Mokrës, 1943

partizane në një formacion më të madh partizan. Që në luftimet të Snosm-Bulçar të krahinës së Vërçës (31 janar 1943) vepronin disa çeta partizane si ajo e Mokrës, Gurës, Oparit dhe ajo Elbasanit që krijuan një shtabin e Çetave partizane me komandant Reshit Çollaku që krijuan një raport në rang batalioni partizan të Mokrës, të cilat zhvilluan me suksese luftimet kundër pushtuesve fashistë italianë në krahinën e Vërçës deri në shpartallimin e plotë të tyre.

Ja si e përshkruan "Heroin e Popullit" Reshit Çollaku, në LANÇ, njeriu i letrave Prof. Dr. Dhimitër Shuteriqi.

## RESHITI I KORËS

*Reshiti i Mokrës ish një trim i rrallë,  
që e kam pasur shok në fëmëni,  
ahere mbante një kapë të lartë  
dhe ne të tjerët i'a kishim zili.  
Unë, kur i shihja shiritat me ar  
Qejfi ma kishte për një maliher  
Reshiti i Mokrës ish një trim i rrallë,  
Fjalën e kishte të prerë porsit thikë  
Ai s'vihej ta ndante qimen katërsh  
Në se të kishte mik apo armik.  
Legjenda, me Lenien, shëmbëllon  
Ku mori fill e Shkumbini u hap  
Të katër urat legjenda shpërthen  
Buzë liqenit ndrit, në Piskupat  
Dhe shkon, Reshiti, maliher në dorë,  
Maj me maj e në gryka zajesh  
Më çapin e tij, kujtimi i tij në Mokër  
Troket zemër më zemër, kushtrim malesh.*

## BATALIONI PARTIZAN I MOKRËS

70 vjet më parë në Mokrën kreshnike u krijua Batalioni i Mokrës, mbi bazën e çetës e mëparshme me një përvojë të madhe në luftën kundër pushtuesve italianë që kishte arritur numrin prej 300 partizanë. Më 17 maj 1943 në fshatin Pleshisht të Mokrës së Sipërme grumbullohen të gjitha forcat partizane të çetës së krahinës, forcat e çetave të vogla në bazë fshati si dhe njësitë guerile shndërrohen në një formacion më të gjerë partizan, pra formohet Batalioni i Mokrës me komandant dhe komisarë.

Komandant i Batalionit u caktua akademisti ushtarak me kulturë evropiane Reshit Çollaku, që patriotët i flaktë që studioi mundësitë për të organizuar në Mokrën kreshnike dhe trime formacione ushtarake. Ai njihte Mokrën dhe mokrarët, që edhe ata e njihnin mirë atë se ishte djali i këtyre maleve dhe e bëri Mokrën një kala më e pamposhtur të

LANÇ-re. Para Batalionit komandanti i Batalionit Reshit Çollaku bëri betimin: "...do ti luftoj deri në fund pushtuesit italianë në këtë luftë çlirimtare, do të jem me popullin miqtë dhe shokët e mi që kanë rrëmbyer armët dhe luftojnë kundër fashistëve italianë këtu në Mokër dhe janë të shumtë. Këtu kemi edhe armiq, bejlerë e ballistë, që na ngatërojnë në punë, na spiunojnë, nxitin hasmëritë, sjellin xhandarë dhe milicë të urryer për të frikësuar popullin, për ta detyruar atë të vejë të punojë tokat e tyre e për t'u marrë të dhjetat e tjera. Prandaj në Mokër duhet ta zgjerojmë dhe thellojmë akoma më tepër luftën tonë, sepse armiqtë do ti shtypin më shpejt dhe populli do të shohë se në gjirin e tij fle një forcë e madhe".

Në batalionin e Mokrës krahas komandantit dhe komisarët dhe zv/komandanti Ethem Haxhiu nga Çezma e madhe të Mokrës së sipërme i cili në shtator të vitit 1942 krijon një çetë të vogël në fshatin e tij për të kujtuar pushtuesit e fashist italianë në krahinën e Mokrës. Veterani i Lanç-it Nuçi Tira, midis të tjerave ka thënë.

Më habiste Et'hemi me mprehtësinë e tij. E ruaj në kujtesën time portretin e tij me një trup të drejtë gjoks të gjerë, fytyrë ezmere e ato mustaqe të holla që bënte për vete. Isha atëherë komisar në çetë e fshatit të Çezmës së madhe që komandanti i saj ishte Et'hem Haxhiu. Ai udhëhiqte çetën e tij duke dhënë shembull personal dhe kërkonte që të gjithë pjesëtarët e çetës ta ndienin veten përgjegjës për çdo detyrë që i ngarkonte çeta që ai drejtonte.

Et'hemi dallohej për zgjuarsin, sinqeritetin, shkathtësinë, e sakrificën në çetë. Ai kishte një miqësi me Rreshit Çollakut, që e donte, e vlerësonte dhe i çmonte shumë cilësitë e mira të tij. Me krijimin e batalionit partizan të mokrës çeta partizane e Çezmës së madhe u inkuadrua më këtë batalion edhe Et'hem Haxhiu, u emërua zv/komandant i tij.

Batalioni i Mokrës i armatosur me se miri i komanduar me mjeshtëri nga heroi i Popullit Rreshit Çollaku filloi menjëherë veprimet luftarake dhe si rrjedhojë Mokra u çlirua dhe u spastrua nga xhandarët milicë e ushtarë të pushtuesve fashistë italianë dhe shërbëtorët të bindur maçokë të tyre. Fshatarët morrin frymë lirisht., u çliruan nga ato taksa shumë të rënda, puna e tyre mbrohej. Ndërsa forcat armike nuk guxonin të futeshin më në krahinën e Mokrës.

Më 24 maj 1943, në fshatin Pleshisht u mblodhën të deleguarit e këshil-

lave nacional çlirimtare të Mokrës për të zgjedhur Këshillin Nacional Çlirimtar krahinor të Mokrës në të cilin hynin Liko Gjona, Isuf Çollaku, Papa Dhimitri, Kokoneshi Maliq Lufe, Papakristo Potgazhani, Latif Kullolli, Xhafer Spahiu etj. Këshillat nacionale çlirimtare të Mokrës u formuan më tej duke filluar të bënin ndarjen e punës ndërmjet anëtarëve: arsim, kulturë, shëndetësi, drejtësi, ekonomi, financë, ndërtim etj. Por çështja kryesore e tyre mbeti gjithmonë mobilizimi i mëtejshëm i fshatarësisë në LANÇ-it.

Komanda e Batalionit Partizan të Mokrës kishte një varg bazash të LANÇ-re në krahinë dhe rrethina si në shtëpinë e Liko Gjona në Laktesh, në Potgozhan të Maro Mokra, në Pleshisht të Thanas Maçolli në Selcën e Sipërme të Vesel Ademi, në Velçan të Maliq Lufo, në Golik të Pasho Kullolli, në Slabinjë të Latif Kullolli, në Çezmën e madhe të Ethem Haxhiu, në Çezmën e vogël të Ibrahim Baçit, në Llëngë të Zyko Kalivaçi etj.

## Pezullimi i shfrytëzimit të minierave të Çervenakës dhe Katielit.

Komanda e batalionit partizan të Mokrës vendosi të shkallmohej dhe të bëhej e papërdorshme miniera e Çervenakës dhe Katielit, për t'ia hequr armikut nga duart këto miniera kombëtare pra këto lëndë shumë të vlefshme për shqiptarët.

Shkatërrimi i këtyre minierave kishte rëndësi politike dhe ekonomike ndikonte shume të gjendjen morale, politiket zonës së Mokrës dhe të gjithë vendit. Për kryerjen e këtij aksioni komandanti i batalionit ndan forcat në dy grupe. Në vajtjen meqë ky fshat ishte më afër forcave italiane shkoi vetë Rreshit Çollaku. Drejtimin e veprimeve të këtij aksioni të madh ushtarak e morri vetë Rreshit Çollaku. Plani i sulmit dhe nxjerrja nga shfrytëzimi minierave ishte hartuar nën kujdesin e tij. Sipas planit veprimet aksion duhej të kryejmë veprime të shpejta dhe vetëm natën për arsye se në ndihmë të minierave mund të mbërrinin nga Pogradeci apo Korça forca të mëdha italiane. Befasia gjithashtu në këto kushte luante rol të dorës së parë.

Për aksionin e Çervenakës dhe Katielit komanda e batalionit caktoi natën e 24 majit 1943. rreth mesnatës partizanët hynë në miniera dhe grupet e shkatërrimit pa vonesë hynë në miniera iu vunë punës për të nxjerr ato jashtë përdorimit dhe për të tërhequr ma-

terialet e nevojshme. Brenda 2-3 orë boshatis miniera nga makineritë dhe pajisjet e punës nëpër galeritë së bashku me specialistët e punëtorët italianë u çuan në Pleshisht të Mokrës. Me porosi të komandantit Rreshit Çollakut punëtorët italianë u trajtuan shumë mirë. Kështu që minierat u bënë të pa përdorshme për një kohë të gjatë. Ja si e përshkruan këtë aksion luftarake në atë periudhë Buletini i Lanç-it më 30 maj 1943:

"Natën e 24 majit forca partizane të batalionit të Mokrës zbritën në rrethin e Pogradecit dhe morrin në dorëzim minierat e kromit të Çervenakës dhe Katielit. Fitorja u arrit pa asnjë humbje. Në Çervenakë u shkatërrua motori e u prishën galeritë, kështu që minierat nuk mund të përdoren më. Barakat që ndodheshin aty u dogjën u morën 18 arka me dinamit, kapsolla e fitila, u gjet një sasi e madhe naftë, katër bare me sende ushqimore, një sasi e madhe materiale pune, si lopata, kazma etj. Shumë tesha fjetje, 2 pushkë. Të gjitha materialet u ngarkuan në 20 kafshë. Gjithçka që u duheshin u morrin të tjerat u dogjën. Në Katjel u shkatërruan galeritë u dogjën motori si dhe gjithë materialet që nuk mund të tërhiqeshin. U morën 5 bare ushqime"

Për këtë aksion të madh të dt.26 majit 1943 njoftuan kryesinë e këshillit të Ministrave të Tiranës.

'Korçë 1- Kuestura e Korçës na referon qe çeta të armatosura të Rreshit Çollakut kanë djegur barakat e shoqërisë A.M.M të vendosura në katund Mëmëlisht të Pogradecit dhe kanë marrë me vete 30 persona' Elbasan 1- Në orën 2 të 26 vijuesit gati 200 të armatosur të kryesuar prej të Rreshit Çollakut kishin shkuar në minierën e Katielit të shoqërisë A.M.M i ndodhur në Katiel të Pogradecit, ku mbasi mbledheshin punëtorët shqiptarë e italianë. Komandanti i mbajti një fjalim. Mbas fjalimit ai urdhëroi djegien e të gjitha barakave të drunjtave të cila u shkatërruan me të gjitha materialin e ndodhura aty të depozituara pranë firmës të shkaktuar një dëm që akoma nuk dihej. Gjithashtu urdhëronte që të pezulloheshin punën e tij u largua mandej në drejtim të Velçanit me gjithë të armatosurit të iknin në drejtim të panjohur. Hetohet.

Në këtë aksion shumë të rëndësishëm partizanët e batalionit të Mokrës treguan trimëri shkathtësi, zgjuarsin si Llazi Angjeli, Dhimitër Runina, Çane Mani, Lutfi Kullolli, Koli Gusho, Riza Balliu, Pasho Kullolli, Xhafer Spahiu etj. Gjatë muajit qershor veprimet e forcave të armatosura partizane u drejtuan kundër objekteve të ndryshme të armikut. Kur forcat të milicisë u orvatën të depërtonin në Mokrën e sipërme një pjesë e forcave të batalionit të Mokrës e sipërme një pjesë r forcave të të batalionit të Mokrës të përshkruar nga çetat vullnetar të fshatarëve e pritën armikun me zgjuarsin duke e detyruar të tërhiqej në panik drejt Pogradecit.

Veprimet të armatosura partizane të batalionit të Mokrës në pika të ndryshme strategjitë në krahinë dhe rrethina sidomos kundër rrugëve të komunikacionit ku qarkullonin forca të shumta ushtarake e vunë armikun në alarm dhe tensione të dukshme gjë që krijoi për të një gjendje pasigurie.

*Shkruar në Pogradec  
Mars-Prill 2013*



# Sfilitjet shpirtërore të Kutelit në penën e Tomi Matos

Nga Kostaq XOXA

Mitrush Kuteli, babai i prozës moderne shqiptare, është patrioti shqiptar, ekonomisti me një vlerësim ndërkombëtar të njohur tashmë për ruajtjen e monedhës së vendit në Rumani dhe në Shqipëri i cili, nga dashakeqët e tij, veçanërisht nga diktatura shqiptare e E. Hoxhës, mbeti i varfër, me gjendje financiare të mjerueshme familjare, gjatë të gjithë jetës së tij, gjer më 5 maj të vitit 1967, kur vdiq. Si drejtor i Bankës Kombëtare në Bukuresht e në Tiranë, smirëzinjtë kanë hamendësuar se do të ishte i pasur në skamje; fashist, kur vjershat e tij kundër okupatorit dëshmonin të kundërtën; nazist, kur Gestapoja gjermane e Hitlerit e çoi në frontin e Moldavisë për ta ndëshkuar se e ruajti valutën rumune nga grabitja e pushtuesve hitleriane; armiq të shokut të dashur Tito, kur nuk pranoi të bënte paritetin e lekut shqiptar të mbështetur në ar, me dinarin jugosllav që s'kishte mbështetje as në bronz.

Libri prej 500 faqesh i mikut të Lasgushit e të Mitrushit, Tomi Matos, i shpjegon hollësisht jo vetëm këto të vërteta, por edhe atë që ai e quan "Kalvari i një jete plot brenga". Kjo okiello - të themi - e librit të tij "Kuteli" gjendet në ballinën e librit, të botuar në vitin 2012. Autori i këtij libri, që mbështetet edhe në qmëtime dhe të dhëna nga intelektualë të tjerë, bën një falënderim të veçantë pa nisur me "Prologun" e librit, ndaj personave që mund të shpreheshin, për hir të njohjeve të drejtpërdrejta me Dhimitër Paskon. Këta përmenden si në trajtë bibliografike: Lasgush Poradeci, Behar Shtylla, Misto Marko, Petraq Kolevica, Irini Shuke (e mbesa Mitrush Kutelit). Libri që po i paraqesim publikut është shtrirë në të gjithë jetën e dallgëzuar të kësaj figure sipërane të vendit tonë, qoftë në rrafshin shkencor të protagonistit të librit, qoftë në atë letrar. Një meritë e qenësishme e autorit, Tomi Mato, qëndron në paraqitjen morale të protagonistit të librit të tij. Dhimitër Pasko ishte një besimtar me bindje të thella të trashëguara, dhe me respekt fetar të patrandshëm. Kryqin e Krishtit e mbante kurdoherë me vete. Ky besim hyjnor e ka ruajtur Dhimitrin nga rreziqe të paimagjinueshme në hetuesi. Tre



hetues nuk kishin mundur dot t'i merrnin firmën për faje të pakryera. Torturat e hetuesisë përshkruhen imtësisht në librin e Tomit. Pasko del në gjyq pa pranuar akuzat false, kaq të rënda sa mund ta kishin çuar në ndëshkim kapital. Shtatë muaj hetuesie të "adhapeve vdekjendjellëse" i kujtojnë autorit atë thënien se edhe guri pëlçet nën rrezet e forta të diellit, por burri - nën torturat e çakënjve të Degës - ja qe nuk plaska. - Letrarët e Realizmit Socialist donin të më izolonin - thotë i burgosuri - që shkruaja jo sipas metodës së tyre, por sipas stilit tim origjinal. Kur bija në gjumë, nga torturat e tmerrshme zgjohesha, por Jesu Krishti më frymëzonte: "Qëndro besnik e i qetë., i palëkundur dhe pa u frikësuar. Tre hetues ndërronin njëri tjetrin "Kush ju dha të drejtën ta gjakosni intelektualin e nderuar Pasko? - e fillonte hetuesinë i katërti. Pastaj, pasi nuk i ecte edhe atij, ai bëhej më i ashpër se të tjerët.

-Firmos se do të ta rrjep lëkurën! Përgjigjja ime: - Ta lexoj se çfarë keni shkruar, pastaj ta firmos. Në Gjyq, prokurori Nevzat Haznedari mundahej që me fraza propagandistike të më bënte të pohoja ato që nuk kisha pranuar në hetuesi: - Kush e priti fashizmin me buqeta me lule, më 7 Prill? Kurse unë citoja vetveten me vjersha që mallkonin fashizmin italian të 7 prillit. Trupi gjykues i quajti si të pabesueshme këto farë "akuza-sh" të prokurorit.



## Një shtatore për aktoren Violeta Manushi në Tushemisht

Një shtatore për aktoren Violeta Manushi do të vendoset në fshatin Tushemisht të Pogradecit. Aktorja e njohur kryesisht për rolet e saj në filmat "Zonja nga yqeti" dhe "Shoqja nga fshati", kishte ndërruar jetë në korrik të 2007-s. Mediat shqiptare kanë shkruar se ka qenë propozim i kryetarit të Komunës Bucimas, Roshi Tollozhina, të cilin e kanë jetësuar dy skulptorët Vasillaq Kolevica dhe Vaskë Spahia. Ata tashmë kanë punuar portretin e aktorese i cili pritet të derdhet në bronz deri më 15 prill, për t'u vendosur më pas në qendër të fshatit deri më 15 maj. "Një figurë e kësaj natyre nuk ishte përfaqësuar në anën e skulpturës. Shtatorja do të vendoset në mes të fshatit Tushemisht, aty ku është xhiruar filmi i famshëm i

"Teta Ollgës", ka thënë Kolevica.

Skulptorët tregojnë se nuk ka qenë shumë e vështirë për ndërtimin e portretit të aktorese Manushi, pasi çdo gjë është udhëhequr nga karakteri i saj i krijuar tek filmat e xhiruar në Tushemisht.

"Personazhi kërkon një hulumtim mbi figurën e saj, mbi shenjat që ka lënë, kërkimin fizik dhe shpirtëror të saj", ka thënë skulptori Spahia.

Violeta Manushi lindi më 1926, në Voskopojë të Korçës. Ajo ishte një nga ikonat e Teatrit Popullor, ndër të parat aktore që ka shkëlqyer njësoj si në komedi, ashtu edhe në dramë, si në skenë ashtu edhe në kinematografi. Gjatë karrierës së saj realizoi më shumë se 100 role në teatër dhe 16 role në kinematografi.



Në numrin e ardhshëm do të botojmë një speciale me ndërtimin e rrugës Qukës- Qafë Ploçë, studimin e plotë mbi rrugën, fondet dhe afatin kohor

## MOKRARËT JAPIN FJALËN, S' KISHIN NEVOJË TË FIRMOSNIN

Nga Zenun FERO

Vështirësia për shkrimin për Mokrën ka qenë kolosale, sepse Mokra, përveç meritave të mira ka edhe një dobësi: Mokrarët nuk e kanë pasqyruar në shkrime historinë e tyre nëpërmjet dokumenteve. Për mokrarët dokumenti ka qenë fjala e dhënë. Nuk janë si ato popujt evropianë, që nga frika se mos shkelet fjala, bëjnë kontrata e shkruajnë marrëveshje. Mokrarët japin fjalën, se s'kishin nevojë të firmosnin. Besimin tek këta me njeri tjetrin nuk kishin nevojë ti shkruanin sepse ish-

in të dy palët mokrarë të bindur dhe të vendosur ta respektonin. Kjo për historinë është fatkeqësi, sa krenari është për mokrarin, aq fatkeqësi është për historinë. Ç'është Mokra? Mokra është një krahinë që rrethohet nga malet, dhe ka bërë një jetë edhe të veçantë dhe të lidhur me të tjerët. Janë gjithë ato gryka që e lidhin me fqinjët, pra nuk është një krahinë e mbyllur. Pak krahina të tjera e kanë këtë veçori. Mokra nuk ka pasur kanun, si e kanë pasur krahinat e tjera, si Mirdita, Dukagjini e të tjerë. Mokra ka pasur kanune që në shekujt mesjetarë që s'kanë lëvizur, janë ndryshkur por dokumente nuk ka, as për marrëveshje, as për gjë tjetër. Ndryshe është

për këto vitet e fundit, shekullin e fundit. Aty dalin dokumente se si u krijua administrata, e si u hapën shkollat.

Mokra ka pasur edhe njerëz të mendimit, ka edhe një mendim të prodhimit intelektual popullor, edhe prodhimin intelektual që quhet refleksi shkencor.

Por Mokra në tërësinë e saj, ka një pasuri të madhe aspektesh të jetës shoqërore, të jetës familjare edhe të jetës krahinore. Luftëtarët nuk janë bërë mënjane por zënë një vend shumë të vogël, se sa të jetë dhe rezistenca që ka zhvilluar Mokra në fushën e së drejtës kanunore dhe në fushën e jetës popullore dhe shoqërore.